



Prania/ Dorezuar Prinjere/ Prerada Received/ Deliverty	27 - 12	2022	2	viti god year
Organ/ Mesta Organ/ Jodimira Org.-Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Pitlog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
KJMSHCK/8487/2022			113	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1002/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1002/2022 të datës 14.11.2022, të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë banimi _____ banesat e _____ Prishtinë kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "*kompensim material*", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 27.12.2022, një zëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.1002/2022 e datës 14.11.2022 e parashtruar nga ankues

A r s y e t i m

Ankuesi _____ punësuar në Komunën e Prishtinës, më datë 13.09.2022 ka parashtruar kërkesë të Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës për kompensim në mënyrë retroaktive të diferencës së koeficientit duke filluar nga data 19.01.2016 deri me datën 01.09.2022.

U.D Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës përmes përgjigjes me numër reference 14-117/01-220635/22 të datës 09.11.2022, ka njoftuar ankuesin se pretendimin për kompensim retroaktiv të koeficientit nga vitit 2016 konsiderohet i pabazuar, sepse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës me Vendimin me numër A.nr. 599/2022 të datës 18.08.2022 nuk ka paraparë kompensimin në mënyrë retroaktive.

Ankuesi me datë 14.11.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin që t'i njihet e drejta e rimbursimit të mjeteve gjegjësisht diferencës së koeficientit në mënyrë retroaktive nga data 19.01.2016 deri me datën e aprovimit të kërkesës për ndryshim të koeficientit të datës 01.09.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 15.11.2022 ka proceduar

kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa me datë 29.11.2022 Këshilli ka pranuar shkresat lidhur me këtë çështje administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7053 të datës 14.11.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë me numër reference 14-117/01-220635/22 të datës 09.11.2022 të Menaxherit të Personelit në Komunën e Prishtinës; Akt emërimit me numër AE.Nr.01-112-540 të datës 01.09.2022; Vendimin me numër 14-020/01-0205673/22 të datës 06.09.2022 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Vendimin me numër A.nr.559/2022 të datës 18.08.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Formularin për kërkesë apo ankesë të datës 13.10.2022; Formularin për kërkesë apo ankesë (pa numër dhe datë); Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 7123/2022 të datës 15.11.2022; Njoftimin lidhur me përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 7463/2022 të datës 29.11.2022; Formularin për kërkesë apo ankesë me numër të protokollit 14-117/01-220635/22; Vendimin me numër 14-020/01-0205673/22 të datës 06.09.2022 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Ankesën me numër të protokollit 3933/2022 të datës 06.07.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Aktin e Emërimit me numër 01.nr.112-540 të datës 01.0.2017; Akt emërimit me numër 01-112-540 të datës 12.03.2013 për pozitën "Zyrtar i Lartë" Akt emërimit me numër 01 nr.112-540 të datës 01.02.2017, e-mailin e datës 22.12.2022 nga Këshilli për emali datës 23.12.2022 nga për Këshillin me shkresat e bashkangjitura/lista e pagave e muajit gusht 2022 dhe lista e pagave për muajin tetor 2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse:*

Lidhur me pretendimin e ankuesit Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: "Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave", si dhe nenit 3 p 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë më të cilin parashihet se: "1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë...., dhe si rrjedhojë konstatoi se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civil të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës dhe që kanë kualifikime dhe përvojën e kërkuar për pozitën respektive, duhet të realizojnë pagë të njëjtë.

Rrjedhimisht, në kuptim të përcaktimit ligjor si me lartë, Kolegji ka analizuar shkresat e lëndës nga konstatoi se ankuesi sipas Aktit të Emërimit më numër 01-112-540 të datës 12.03.2013 ka qenë i emëruar në pozitën e punës me titull "Zyrtar i Lartë" në Sektorin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Prishtinës. Duke u bazuar në Vendimin me numër protokollit 01 Nr.031-13761 të datës 19.01.2016 për organizmin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale, Kryetari i Komunës së Prishtinës ka nxjerrë Akt Emërim me numër protokollit 01-112-540 të datës 01.02.2017, me të cilin ankuesin e ka sistemuar në pozitën e punës Zyrtar për Blegtori, Bletari dhe Veterinari. Këshilli duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesit të datës 24.05.2017, me Vendimin me shenjë A 02/269/2017 të datës



20.07.2017 ka detyruar Kryetarin e Komunës së Prishtinës që të rishqyrtoj sistemimin e ankuesit nga pozita e Zyrtarit të lartë në pozitën e Zyrtarit për Blegtori, Bletari dhe Veterinari.

Ankuesi për shkak të moszbatimit të Vendimit të Këshillit A 02/269/2017 të datës 20.07.2017 serish me datë 06.07.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil duke kërkuar ndryshimin e Akt Emërimit nga Zyrtar në Zyrtar të lartë, ndërsa Këshilli me Vendimin A.nr.599/2022 të datës 18.08.2022 ka obliguar Kryetarin e Komunës së Prishtinës që ankuesit ti lëshoj Akt emërim në pajtim me klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil të Komunës së Prishtinës dhe Rregulloren për Organizmin dhe kompetencat, Përgjegjësitë dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës së Administratës Komunale të Komunës së Prishtinës duke marrë parasysh kualifikimin dhe përvojën e ankuesit.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit A.nr.599/2022 të datës 18.08.2022, U.D menaxheri i Personelit të Komunës së Prishtinës ka nxjerrë Akt Emërim për ankuesin me shenjë AE.Nr.01-112-540 të datës 01.09.2022 lidhur me pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Projekte me kod EZHE/430* me koeficient tetë (8) të pagës.

Andaj, Kolegji bazuar në shqyrtimin e provave të lëndës konstatoi së janë të pabazuar pretendimet e ankuesit që ti njihet e drejta e kompensimit të diferencës së koeficientit në mënyrë retroaktive nga data 19.01.2016 deri me datën 01.09.2022, sepse sipas Aktit të Emërimit me numër 01-112-540 të datës 12.03.2013 lidhur me pozitën Zyrtar i Lartë në Sektorin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ankuesi ka realizuar koeficient shtatë (7), dhe po ashtu bazuar në Akt Emërimin me numër protokolli me numër protokolli 01-112-540 të datës 01.02.2017 dhe listës së pagës së muajit gusht 2022 ankuesi ka realizuar koeficient shtatë (7) të pagës për pozitën Zyrtar për Blegtori, Bletari dhe Veterinari, kështu që mbi bazën e këtyre fakteve rrjedhë së ankuesi nuk është dëmtuar në raport me të drejtën e pagës pasi që ka realizuar koeficient të njëjtë.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente/Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 1002/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit;
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSË- së;

